# Trajnim për Shkrimin Akademik
# Hyrje në Zotero

## Menaxhimi elektronik i burimeve bibliografike me platformën Zotero

Organizuar nga Zyra e Ekselencës | Data: 8 Prill 2025 | Adresa: Biblioteka Shkencore e Universitetit
Forma e organizimit: Trajnim me pjesëmarrje fizike

Elvisa **Drishti**, PhD & Noel **Radovani**, Specialist/Webmaster

Zyra e Ekselencës | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" | Sheshi "2 Prilli", 4001, Shkodër, Shqipëri
Tel.: +355 (0) 69 72 36 427 | Email: ze@unishk.edu.al |Web: www.unishk.edu.al
*Promovojmë cilësinë, transparencën dhe integritetin në kërkimin shkencor*

# Përmbajtja e Prezantimit

- Menaxhimi i informacionit: Një “e keqe” e domosdoshme

- Çfarë është Zotero? – Bazat

- Çfarë mund të bëj me Zotero?
  - Hyrje dhe demonstrim

- Ushtrime individuale të ilustruara në trajnim

# Menaxhimi i informacionit: Një “e keqe” e domosdoshme

- Menaxhimi i informacionit është thelbësor për proceset e suksesshme të shkrimit të teksteve të gjata
  - MSc, MA dhe PhD!

- Me “menaxhim informacioni” nënkuptojmë në mënyrë të përgjithshme:
  - mbledhjen,
  - ruajtjen,
  - përshtatjen,
  - organizimin
  - dhe ndarjen e informacionit të gjetur në kontekste të ndryshme.

- Çdo studiues ka një sistem për të organizuar informacionin.
- Shumë prej këtyre sistemeve janë (shumë) jofunksionale.
- Si mund t’i përmirësojmë ato?

# Kriteret e Përzgjedhjes

- Ekziston një shumëllojshmëri mjetesh komerciale dhe jo-komerciale për menaxhimin e informacionit.
  - Shembuj: EndNote, Mendeley, RefWorks, Citavi, etj.

- Kriteret e përzgjedhjes përfshijnë:
  - Funksionalitetin
  - Përshtatshmërinë për projektin individual
  - Koston
  - Qëndrueshmërinë
  - Preferencat personale
  - Kombinimi i këtyre faktorëve ndihmon në marrjen e një vendimi të informuar.

- Shih gjithashtu:
  - Wikipedia – Krahasimi i Programeve për Menaxhimin e Referencave
    - https://en.wikipedia.org/wiki/Comparison_of_reference_management_software

# Një Mjet mes Shumë Opsionesh

- Kjo hyrje do të fokusohet në një mjet falas dhe me kod të hapur, që ofron një zgjidhje për "të keqen e domosdoshme" të menaxhimit të informacionit. I disponueshëm për:
  - Mac OS X,
  - Windows dhe
  - Linux
  - dhe mund të zgjerohet përmes shtojcave që i shtojnë funksione të reja sipas nevojave të studiuesve.

- Zhvilluesit e Zotero janë vetë akademikë:
  - Zotero është prodhuar nga Qendra për Historinë dhe Median e Re në George Mason University (SHBA).

- Megjithatë, ka shumë alternativa të mira, si p.sh. Mendeley – dhe secili duhet të gjejë strategjinë më të përshtatshme për vete.

# Çfarë është Zotero? – Bazat

- Zotero është një aplikacion me burim të hapur për menaxhimin e referencave bibliografike, i krijuar për të mbledhur, organizuar dhe cituar burime kërkimore.

- Ky mjet është veçanërisht i dobishëm për studentët dhe studiuesit që shkruajnë punime shkencore, disertacione apo libra, dhe që kanë nevojë për bibliografi në formate të standardizuara si APA, Chicago ose MLA.

- Zotero integron metadata bibliografike, shënime, skedarë bashkëngjitës dhe të dhëna përdoruesi, dhe funksionon me programe përpunimi teksti si Microsoft Word, LibreOffice dhe Google Docs për krijimin e citimeve brenda tekstit dhe listave bibliografike.

- Karakteristikat kryesore përfshijnë:
  - Ekstraktim automatik të metadatave nga burime onlineIndeksim i përmbajtjes për kërkime të plota
  - Etiketim dhe organizim tematik i literaturës
  - Sinkronizim në cloud për akses në disa pajisje
  - Sistem zgjerimi me shtojca të zhvilluara nga komuniteti

# Hapat e Parë: Instalimi i Zotero

- Si të Nisim me Zotero?

1. Instalimi i aplikacionit ne desktop
   - Behet duke vizituar https://www.zotero.org/ dhe duke shkarkuar versionin përkatës për sistemin tuaj operativ.
2. Rekomandohet gjithashtu të instaloni shtojcën për shfletuesin (browser extension) që përdorni (në këtë trajnim do të përdorim Chrome.), në mënyrë që Zotero të mund të identifikojë automatikisht metadata në faqet e internetit.
   - Zotero përdor "përkthyes" të shkruar në JavaScript për të përpunuar të dhëna të strukturuara nga katalogë bibliotekash apo databaza akademike
3. Konfigurimi në Microsoft Word
   - Zotero instalohet me një shtojcë për Word
   - Ju mundëson të futni citime dhe të krijoni bibliografi automatikisht gjatë shkrimit

# Hapat e Parë: Funksionet Bazë të Zotero

- Çfarë lloj materialesh mund të ruhen dhe organizohen?
  - Çdo njësi përmban metadata të ndryshme, në varësi të tipit. Ato mund të jenë:
    - libra
    - artikuj shkencorë
    - Dokumente
    - faqe internet
    - vepra arti
    - Filma
    - regjistrime audio
    - projektligje,
    - çështje gjyqësore, akte ligjore, etj.

- Si funksionon ndërfaqja?
  - Kolona e majtë: Biblioteka kryesore ("My Library") dhe nënbibliotekat
  - Kolona qendrore: Lista e njësive brenda një koleksioni
  - Kolona e djathtë: Tabelat me metadata, shënime dhe etiketa për çdo njësi të zgjedhur

  - Metadata përkatëse (titulli, autori, botuesi, data, etj.) shfaqen në kolonën e djathtë dhe shërbejnë për citim të saktë.

# Hapat e Parë:
# Si të shtojmë materiale në Zotero?

1. Kapja automatike nga internet
   - Kur Zotero është aktiv në shfletues, një ikonë shfaqet në shiritin e adresës.
   - Në varësi të faqes, ajo ikonë mund të përfaqësojë: libër, artikull, imazh apo dosje.
     - Klikimi mbi ikonën shton automatikisht materialin në bibliotekën tuaj
     - Nëse disponohet PDF me tekst të plotë, ai bashkëngjitet automatikisht

2. Kapje e shumëfishtë (multiple capture)
   - Kur faqja përmban disa materiale (p.sh. një faqe me disa artikuj), shfaqet ikonë-dosje.
   - Përdoruesi mund të përzgjedhë cilat artikuj të importojë në Zotero.

3. Shtimi manual i materialeve
   - Nëse materiali nuk kapet automatikisht:
     - Klikoni butonin “New Item” dhe përzgjidhni llojin përkatës
     - Plotësoni manualisht metadata në kolonën e djathtë

# Ndërfaqja ne desktop



# Browser extension ne Chrome






# Konfigurimi në Microsoft Word









# Citimet dhe Bibliografitë në Zotero

- Formate të shumta citimi
  - Zotero mbështet një gamë të gjerë stilistikash bibliografike, përfshirë: APA, MLA, Chicago, si dhe formate specifike për revista shkencore.
  - Nëse një stil nuk ofrohet, mund të kërkohet përmes faqes zyrtare të Zotero.
- Integrimi me procesorët e tekstit
  - Zotero ofron shtojca për Microsoft Word dhe OpenOffice, duke ju lejuar të futni citime direkt nga programi i shkrimit.
  - Mbështet citime në tekst, shënime në fund faqeje dhe shënime fundore.
- Bibliografi automatike
  - Përmes shtojcave të Zotero, mund të:
    - Ndryshoni stilin e citimit për të gjithë dokumentin
    - Gjeneroni automatikisht bibliografinë bazuar në burimet e cituara
- Bibliografi manual
  - Citimet dhe bibliografitë mund të futen edhe manualisht:
  - Me drag-and-drop
  - Përmes opsionit Quick Copy
  - Ose duke i eksportuar në skedar të jashtëm



# Funksionalitete të Avancuara I: Bashkëpunimi në Zotero

- Sinkronizimi (Syncing)
  - Zotero mund të përdoret në disa pajisje falë funksionit të sinkronizimit.
    - Të gjitha materialet ruhen dhe sinkronizohen në serverët e Zotero, duke mundësuar akses në çdo kompjuter ku jeni i regjistruar.
  - Zotero Server
    - Përmes llogarisë suaj në zotero.org, mund të:
      - Hyni online në bibliotekën tuaj të sinkronizuar
      - Ndani literaturën me kolegë apo bashkëpunëtorë
  - Grupet (Groups)
    - Përdoruesit mund të krijojnë grupe bashkëpunimi ose me interes të përbashkët, ku:
      - Menaxhojnë në mënyrë kolektive burimet kërkimore
      - Ndajnë referenca, shënime dhe skedarë, si në versionin online ashtu edhe në aplikacionin Zotero

# Funksionalitete të Avancuara II: Importimi i Literaturës

- Importimi nga mjete të tjera
  - Shumë përdorues kalojnë në Zotero pasi kanë krijuar koleksione të mëdha në mjete të tjera si EndNote, RefWorks apo Mendeley.
  - Për të importuar materiale:
    - Klikoni ikonën e ingranazhit në Zotero
    - Zgjidhni “Import” dhe përzgjidhni skedarin përkatës nga kompjuteri
    - Zotero do ta krijojë koleksionin e importuar në një dosje të veçantë
  - Formatet që mbështeten për importim përfshijnë:
    - BibTeX
    - RIS (përdoret nga EndNote, RefWorks, etj.)
    - Refer/BibIX

# Burime për Mësim të Mëtejshëm mbi Zotero

- Bazë
  - Zotero Support – http://www.zotero.org/support/
  - Zotero Forums – http://forums.zotero.org/categories/
  - Biblioteka e Harvard Kennedy School – http://www.hks.harvard.edu/library/research/zotero.htm
  - California State Polytechnic University, Pomona – http://libguides.library.csupomona.edu/zotero

- Avancuar
  - Puckett, Jason. Zotero: A Guide for Librarians, Researchers, and Educators.Chicago: Association of College and Research Libraries, 2011.